



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT

Durrës, më 13.03.2026

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: *“Blerje gaz i lëngshëm për gatim”.*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TËPROKURIMIT(FPP): Gaz i lëngshëm propan 09122110-4, butan 09122110-5.

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,716,000 *(një milion e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë)* Lek pa TVSH.

Afati kohor: Për realizimin e punës dhe zbatimin e kontratës duhet të jetë 12 *(dymbëdhjetë)* muaj,

Argumentim:

**MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS
LIMIT TË KONTRATËS**

Në zbatim të ligjit nr 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM nr 285 dt 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021, VKM 291 dt 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, e Ligjit nr 10296 “dt 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, VKB nr 73 dt 23.12.2025 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm 2026-2028” Në zbatim të urdhrit të grupit të specifikimeve nr.9 e nr.451 prot., datë 10.03.2026 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkisë Durrës, “Për ngritjen e grupit te punës për hartimin e Specifikimeve Teknike si dhe Përlllogaritjen e Fondit Limit, për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje gaz i lëngshëm për gatim”,Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si

më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;

Grupi i punës realizojë punë kërkimore mbi çmimet orientuese për mallrat, të cilat janë objekt prokurimi; duke u bazuar në Çmimet e Instatit, hetimin e tregut vendas si dhe kontratat e mëparshme, nisur nga kriteret e përcaktuara nga komisioni, u testua tregu si dhe çmimet e kontratave të mëparshme.

I. PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Pas shqyrtimit të informacionit mbi të dhënat teknike komisioni vërejtë se:

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndyshuar, neni 40.

II. PËRLLOGARITJA E VLERES LIMIT TË KONTRATËS

Për përllogaritjen e çmimit janë marrë në konsideratë:

- a) Çmimi i referuar nga bursa, datë **09 mars 2026**, sipas PLATTS, i llogaritur sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë date 09 mars 2026, Buletin e Njoftimeve Publike të APP., nr. 16 datë 23.02.2026, si dhe sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ku janë përfshirë elementët përbërës të çmimit, konkretisht: çmimi i produktit, taksat (akciza), marzhin e fitimit, si dhe tarifat e tjera të aplikueshme.
- b) Marzhi i fitimit për njësi, i përcaktuar në nivel prej 20 lekë/litër në përputhje me ofertat e marra gjatë testimit të tregut.

Nga përpunimi i të dhënave rezultoi se:

- a) Buletini i çmimeve, datë **09 mars 2026**, është marrë si referencë për përllogaritjen e çmimit.
- b) Kursi zyrtar i këmbimit të Bankës së Shqipërisë date 09 mars 2026;
- c) Premio mbi çmimin e references
- d) Taksat përfshijnë: akcizën .
- e) Dendësia e përdorur është ajo standarde për karburantet përkatëse për gazin 0.52.

Në përfundim, Komisioni përpunoi të dhënat në një tabelë përmbledhëse, bazuar në metodologjinë e përcaktuar më sipër, nga e cila rezulton se:

Vlera e përgjithshme e kontratës së blerjes së gazit të lëngshëm për vitin 2026, me afat zbatimi 12 muaj deri në mbarimin e sasisë , është si më poshtë:

Vlera e fondit limit të jetë: 1,716,000 (një milion e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lek pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

III. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 42 pika 3, nenit 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 40 pika 3 ku përcaktohet se: “ Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përputhje me detyrën lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave” duke qënë se vlera e fondit limit të objektit përkatës është nën kufirin e ulët monetar kriteri hartohet në përputhje me vlerën procedurës. Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit objektin është nën kufirin e ulët monetar që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 55 pika 4 e VKM Nr.285, dt.19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të

kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimimi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumnin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

2.2.3 *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2025 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).*

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST. Në zbatim të përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2025*

ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, , nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se se 20% të vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4 germa b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenit 55 pika 4, germa b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizimin/liçensë për tregëtimin e bombolave të GLN për përdorim rezidencial lëshuar nga *Inspektoriati Shtetëror teknik dhe Industrial*

Argumentimi. Në zbatim të ligjit nr. 8450, date 24.02.1999 i ndryshuar, kreu 2, neni 11, shkronja d), Vendimit Nr. 212 datë 16.3.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngëzuar të naftës GLN”, ligjit 10489/2011 “Për mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore”, i ndryshuar, VKM nr. 1047 datë 16.07.2008 Per disa ndryshime dhe shtesa ne Vendimin nr. 170 date 25.04.2002 te Keshillit te Ministrave “Per përcaktimin e procedurave dhe kushteve per dhenien e lejeve dhe te autorizimeve, per tregjetimin e naftes, gazit e nenprodukteve te tyre”, te ndryshuar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar edhe bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

2.3.3 Operatori ekonomik të paraqesë licencë të vlefshme për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, lëshuar nga organet e pushtetit vendor (në përputhje me nenin 11 gërma 'd' dhe nenin 20, pika 2 të ligjit nr.8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre" i ndryshuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ne piken 5 /a te nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: 5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, si dhe bazuar ne nenin 11 gërma 'd' dhe nenin 20, pika 2 të ligjit nr.8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre" i ndryshuar.

Paraqitja e licences eshte kerkuar per te vertetuar se operatori ekonomik ushtron aktivitet te rregullt ne perputhje me legjislacionin ne fuqi per fushen perkatese. Ky kriter eshte vendosur me qellim qe ti sherbeje AK per tu siguruar se operatori ekonomik ploteson kushtet dhe rregullat teknike sipas legjislacionit ne fuqi.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- | | |
|---|---------|
| a. Drejtues mjete | 1 (një) |
| b. Punonjës të kualifikuar për montim
çmontim të bombulave | 2 (dy) |

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim përmes formës elektronike me listë-pagesën, jo më pak se 2 punonjës

- Në rastet kur mjete i transportit është në pronësi ose në përdorim të operatorit ekonomik, shoferi që drejton këtë mjet mund të jetë i angazhuar nga operatori ekonomik me kontratë pune, pa qenë e domosdoshme që të rezultojë në listëpagesat e paraqitura në dokumentacionin e tenderit.
- Jo më pak se 2 punonjës të pajisur me Certifikatë Profesionale.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST. Në zbatim të përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligji Nr. 32/2016 Për garantimin e Sigurisë së Punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”, Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorë ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e kësaj kontrate Numri i kërkuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Personeli i mësipërm kërkohet referuar shpërndarjes gjeografike të kopshteve dhe çerdheve në qytetin e Durrësit, për arsye se furnizimi është ditore dhe në orë të caktuara, pra është e nevojshme një numër minimal prej 3 punonjësish nga të cilët një prej tyre të jetë drejtues mjete dhe 2 të tjerët të jenë të specializuar, të cilët duhet të jenë dhe të certifikuar për montim çmontim të bombolave. Kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar të cilët disponojnë certifikatë të leshuar nga institucionet përkatëse shtetërore apo subjekte private të licensuara për këtë aktivitet të cilët do të jenë përgjegjës për instalimin e bombolave.

2.3.5 Operatori Ekonomik, për sigurinë e furnizimit dhe realizimit të nevojave të Çerdheve dhe Kopshteve Publike të Durrësit, duhet të ketë jo më pak se 1 (një) kamionçinë e cila të jetë në pronësi ose në përdorim, për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

- a. Kamionçinë me kapacitet jo më shumë se 1.5 ton 1 (një)

Vërtetuar me dokumentacionin si më poshtë:

- Leje qarkullimi
- Certifikatë pronësie
- Siguracion TPL
- Certifikatë e Kontrollit Teknik
- Certifikatë ADR (për transportin e lëndëve të rrezikshme).

Për mjetet dhe pajisjet e sipërcituar të vetdeklaroje: Dëshmi, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentet si: Leja e qarkullimit, Çertifikata e Kontrollit Teknik, Foto e mjetit (Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në regjistra publike duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe librezat/te dhëna teknike, ose ekuivalenti i tij/saj).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST. Në zbatim të përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentim: *Kërkesa që OE duhet të disponojë (një) automjet transporti me masë maksimale të autorizuar jo më shumë se 1.5 ton, të pajisur me Certifikatën ADR (për transportin e lëndëve të rrezikshme), , është vendosur duke patur parasysh nevojat e AK për gaz të lëngët, në zbatim të kërkesave për furnizimin e 2 konvikteve, 13 kopshteve dhe 6 çerdheve, duke patur parasysh dhe shpërndarjen e tyre gjeografike në gjithë Bashkinë e Durrësit si dhe në zbatim të Ligjit nr. 118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”.*

Si edhe në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a. Certifikatë ISO 9001 - Sistemi i Menaxhimit të cilesisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b. Certifikatë ISO 14001 - Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.;

Argumentimi: *Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të Nenit 79, pika 1 të ligjit nr 162 dt 23.12.2020 per “Prokurimin publik” si dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 44 ku cilësohet*

se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e investimit/kontratës. ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Autoriteti Kontraktor kërkon pajisjen e operatorit ekonomik me këtë certifikatë, pasi gazi është një produkt cilësia jashtë standartit e të cilit do të ndikonte keq ne mjedis. Sistemi i Menaxhimit Mjedisor ISO 14001 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që produktet kanë mbi mjedisin.

2.4.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizën e vlefshme të gazit, lëshuar nga një laborator i akredituar në Republikën e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesa që OE duhet të paraqesë fletë analizën e vlefshme të gazit, lëshuar nga një laborator i certifikuar në Republikën e Shqipërisë është vendosur në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për Përpunimin, për Transportin dhe Tregtimin e Naftës, të Gazit dhe nënprodukteve të tyre, i ndryshuar”, Urdhërit nr. 6 datë 09.01.2015 të Ministrisë së Energjisë dhe Turizmit “Për kontrollin dhe standardet teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj.....” Pika I ku përcaktohet: Kontrolli i cilësisë së naftës dhe nënprodukteve të saj bëhet në zbatim të VKM nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzine dhe diezel”, të VKM nr. 781, datë 14.11.2012 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)” dhe të metodikave të testimit të standardeve përkatës në fuqi, të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimeve, në Laboratorin e akredituar të Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës (ISHP) ose në laboratorë të tjerë të akredituar”.

2.4.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë “**Policën e Sigurimit**” të vlefshme në datën e hapjes së ofertave, me të cilën merr persiper shperblimin e demit të shkaktuar nga defektet që mund të vijne nga përdorimi i gazit të lëngët.

***Argumentim:** Kërkesa që OE duhet të paraqesë “Policën e Sigurimit” me të cilën merr persiper shperblimin e demit të shkaktuar nga defektet që mund të vijne nga përdorimi i gazit të lëngët është vendosur në zbatim të VKM nr. 212, datë 16.03.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe rregullave teknike për përpunimin e bombolave të gazit të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës GLN, Kreu 6, Pika 8, ku përcaktohet: “Konsumatori jofamiljar që përdor bombol të mbushur me GLN, duhet të jetë i pajisur me një kontratë sigurimi me një shoqëri sigurimesh, për të garantuar rimbursimin e dëmeve të shkaktuara ndaj palëve të treta, në rast aksidenti prej këtyre sistemeve dhe bombolave të GLN-së.*

2.4.4 Operatori ekonomik të mundësojë furnizimin me gaz me karta elektronike dhe për këtë duhet të paraqesë deklaratën si më poshtë:

- a. Të deklarojë se merr përsipër furnizimin me gaz të lëngshëm të stacioneve të shitjes me pakicë nga ora 08.00-14.00 nga e hëna në të premte.
- b. Të deklarojë se merr përsipër furnizimin me gaz të lëngshëm nëpërmjet kartave elektronike të subjekteve në varësi të Institucionit, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor .

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë mundësinë e furnizimit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, sipas adresave të përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor.

- Bazuar në VKM nr 561 dt 29.07.2016 ”Për standartet e disiplinimit të shpenzimeve të karburantit në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Operatori Ekonomik duhet të ofrojë faqe të menaxhimit të karburanteve (Gazit) (Web page), ku Institucioni përfitues të mund të monitorojë furnizimet dhe konsumin e gazit.
- Faqja e menaxhimit duhet të ofrojë të dhëna në kohë reale mbi furnizimin dhe konsumin, përfshirë datën, orën, sasinë dhe targën e mjetit, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- Operatori Ekonomik duhet të vendosë një sistem kontrolli dhe monitorimi të sasisë së gazit të furnizuar, si edhe të mundësojë akses për verifikim nga Autoriteti Kontraktor.

Shënim: Sasi të kërkuara nga AK janë sasi të pritshme, të llogaritura mbi bazën e çmimit mesatar të përlllogaritur sipas të dhënave të Bursës ”PLATTS” të datës 09.03.2026. Këto sasi mund të ndryshojnë në varësi të çmimit të publikuar nga APP në buletin javor.

Mosdorëzimi i informacionit të saktë, apo paraqitja e të dhënave të rreme do të lkosiderohet kusht për skualifikim dhe/ose fillimin e procedurave për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

2.4.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **një vetëdeklarim** ku të deklarojë se do të respektojë kushtet dhe rregullat teknike për përpunimin e bombolave dhe të deklarojë se ka në stafin e tij punonjës të certifikuar për të bërë instalimin, testimin, si dhe çdo aspekt tjetër teknik që lidhet

me objektin e prokurimit, për dorëzimin dhe instalimin e bombolave të gazit në kuzhinat e institucioneve në varësi të QEA.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në pikën 8 të nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në ligjin nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar. Paraqitja e këtij vetëdeklarimi është kërkuar për të vërtetuar se operatori ekonomik ushtron aktivitet të rregullt në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe respekton kushtet dhe rregullat teknike. Ky kriter është vendosur me qëllim që t’i shërbejë AK për të siguruar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet teknike (bombola gazi të testuara për sigurinë e tyre, punonjës të certifikuar për instalimin e tyre si dhe mjetin e përshtashtëm për transport) për të përmbushur me sukses kontratën.*

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s`kualifikim.

II Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në specifikimet teknike të hartuara nga struktura e posaçme e ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor konstatohet se plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 40 pika 2 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në këto kushte njësi e prokurimit po publikon specifikimet teknike.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Bazuar në specifikimet teknike të hartuara nga struktura e posaçme e ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor konstatohet se plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 40 pika 2 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në këto kushte njësi e prokurimit po publikon specifikimet teknike.

Specifikimet teknike dhe fondi limit i kontratës janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT,

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit